



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

*Nr. 163 Datë 17.12.2012*

**MBI**

**ANKANDIN VJETOR DHE MUJOR TE KAPACITETEVE TË  
INTERKONJEKSIONIT TË VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe Kapitullit X, pika 2, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.12.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Vendosi:**

1. OST sh.a të shtyjë zhvillimin e ankandit vjetor për kapacitet ndërkuftare deri ne daten 22.01.2013.
2. OST sh.a të alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë kapacitetet ndërkuftare të interkonjeksionit për muajin Janar 2013, ne drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistem.

3. OST sh.a të zhvillojë ankand për muajin Janar 2013 për kapacitetet e mbetura ndërkufitare, ne drejtimin e importit, pas plotësimit të pikës 2 te ketij Vendimi.
4. OST sh.a. te zhvilloje ankandin per muajin Janar 2013 per kapacitetet nderkufitare ne drejtim eksporti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**